



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2020:062712  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05754619

**C.nr.571/20**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses A.Th., nga fshati R. Komuna e P., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor babai S.Th. e të cilët i përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “ N.....” L.LC, me seli në P., me autorizim, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “P...”, me seli në P., me bazë juridike kompensim dëmi nga autopërgjegjësia, vlera e kontestit 22.417 euro, jashtë seance, me datën 30.05.2024 mori dhe përpiloi këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSTATOHET e tërhequr** padia e paditëses A.Th., nga fshati R. Komuna e P., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor babai S.Th. e parashtruar me datë 04.06.2020, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “P...” me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensim dëmi nga auto-përgjegjësia, vlera e kontestit 22.417 euro.

**II.** Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.

**Arsyetim**

Në këtë gjykatë paditësja A.Th., nga fshati R. Komuna e P., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor babai S.Th. përmes të përfaqësuarit e tyre Shoqëria e Avokatëve “ N.....” L.LC, me seli në Pejë ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “P...”, me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensim dëmi nga auto-përgjegjësia, vlera e kontestit 22.417 euro.

Gjykata, me aktvendimin e datës 24.07.2023, ka bërë bashkimin e lëndëve C.nr.1276/20 dhe C.nr.517/20.

Gjykata, me datën 13.03.2024 ka pranuar parashtrësës e paditëses, me anë të së cilës parashtrësë, e njëjta ka deklaruar se e tërheqë padinë C.nr.571/20 dhe C.nr.1276/20, ndaj të paditurës me arsyetim se për këtë çështje kontestimore kanë lidhur ujdi jashtëgjyqësore në emër të dëmit jo material dhe material, duke ja bashkëngjitur ujdinë jashtëgjyqësore të datës 12.03.2024.

Sipas nenit 261 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se I padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohej për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*, andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 261 par.1, 2, 3, 4 dhe 5 lidhur me nenin 387 par.1, pika c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.571/20, me datë 30.05.2024**

**Gjyqtarja,**  
Rajmonda Kurteshi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.